

VENDIM
Nr.1520, datë 21.11.2008

**PËR SHTYRJEN E AFATIT TË BOTIMIT TË NJOFTIMIT TË FITUESIT DHE TË
NJOFTIMIT TË KONTRATËS SË LIDHUR, PËR PROCEDURAT E PROKURIMIT TË
KRYERA NGA MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE DISA INSTITUCIONE NË
VARËSI TË SAJ, SI AUTORITETE KONTRAKTORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe disa institucioneve në varësi të saj t'i përfundojnë, deri në datën 22 dhjetor 2008, procedurat e prokurimit, për mallra, shërbime dhe ndërtime, me fondet e parashikuara në Buxhetin e Shtetit të vitit 2008, sipas aneksit nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Brenda këtij afati përfshihen edhe lidhja e kontratave përkatëse dhe publikimi i njoftimit të kontratës së nënshkruar, në Buletinin e Njoftimeve Publike.

2. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë, institucionet në varësi të saj dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

ANEKSI NR.1

I. Procedura që zhvillohen nga Ministria e Shëndetësisë:

1. Informatizimi i arkiv-protokollit në Ministrinë e Shëndetësisë, me fond limit 4 166 600 lekë pa TVSH.

2. Sistemi i informacionit për Kujdesin Shëndetësor Parësor, me fond limit 20 818 750 lekë pa TVSH.

3. Projektpreventiv zbatimi për ndërtimin e godinës të sëmundjeve akute:

- spitali Shkodër, me fond limit 1 333 334 lekë pa TVSH.

II. Procedurat që zhvillohen nga institucionet spitalore të varësisë:

- Procedura për të cilat është shpallur fituesi, por nuk është nënshkruar kontrata:

a) Drejtoria e Shëndetit Publik Pogradec:

“Blerje lënde djegëse për ngrohje”, me fond limit 2 833 600 lekë.

b) Drejtoria e Shëndetit Publik Krujë:

“Blerje pajisje mobilimi për spitalin Krujë”, me fond limit 8 000 000 lekë (me TVSH).

“Blerje pajisje mjekësore për DSHP-në Krujë”, me fond limit 2 000 000 lekë (me TVSH).

“Blerje pajisje mjekësore për spitalin Krujë”, me fond limit 15 000 000 lekë (me TVSH).

Ky fond u nda në dy lote: 9 000 000 lekë (me TVSH) do të tenderohet nga Ministria e Shëndetësisë, ndërsa 6 000 000 lekë (me TVSH) do të tenderohet nga DSHP-ja Krujë.

c) Drejtoria e Shëndetit Publik – Pukë:

“F.V. kaldajë për spitalin Pukë”, me fond limit 1 500 000 lekë (me TVSH).

d) Drejtoria e Shëndetit Publik – Skrapar:

“Blerje pajisje mjekësore për spitalin Skrapar”, me fond limit 1 300 000 lekë (me TVSH). Është tenderuar me vlerë 1 284 000 lekë (me TVSH).

“Blerje pajisje teknologjike për spitalin Skrapar”, me fond limit 1 000 000 lekë (me TVSH). Është tenderuar me vlerë 974 400 lekë (me TVSH).

e) Spitali Gjirokastrë: “Instalimi i pompave të ujit teknologjik për spitalin Gjirokastrë”, me fond limit 2 000 000 lekë (me TVSH). Është tenderuar me vlerë 1 994 520 lekë (me TVSH).

f) Drejtoria e Shëndetit Publik – Tepelenë: “Rikonstruksion i katit përdhe dhe çatisë së godinës dhe Tepelenë” me fond limit 4 400 000 lekë (me TVSH).

g) Drejtoria e Shëndetit Publik – Sarandë: “Ndërtim i murit mbajtës për urgjencën e re spitali Sarandë” me fond të çelur për vitin 2008, 5 000 000 lekë (me TVSH).

“Blerje pajisje mobilimi për urgjencën e spitalit Sarandë” me fond limit 2 500 000 lekë (me TVSH) është shpallur fituesi.

“Projektpreventiv zbatimi për rikonstruksionin e godinës së vjetër, spitali Sarandë”, me vlerë limit 3 000 000 lekë (me TVSH).

h) Qendra Kombëtare e Teknikës Bio-Mjekësore — Tiranë: “Projektpreventiv zbatimi për rikonstruksionin e godinës së oficinës Tiranë”, me vlerë limit 1 500 000 lekë (me TVSH). Pritet të lidhet kontrata.

i) Drejtoria e Shëndetit Publik – Kukës: “Rikonstruksion i ambienteve të reja për DSHP Kukës”, me vlerë të akorduar për vitin 2008, 10 000 000 lekë (me TVSH), tenderuar me vlerë të plotë 18 000 000 lekë (me vlerë të plotë).

j) Autoriteti Shëndetësor Rajonal – Tiranë:
“Rikonstruksion i godinës 1-kat pranë poliklinikës nr.9 për vendosjen e aparatit të radiologjisë” me fond limit 1 500 000 lekë (me TVSH).

“Blerje E.E.G për poliklinikën qendrore Tiranë” me fond të akorduar 1 333 333 lekë (pa TVSH).

k) Spitali Fier: “Mirëmbajtja e objekteve ndërtimore, impiantistikës dhe zyrave”, me fond limit 1 995 280 lekë (pa TVSH).

“Blerje lëndë djegëse për ngrohje” me fond limit 5 010 440 lekë (pa TVSH).

m) Spitali psikiatrik Vlorë:

“Projektpreventiv zbatimi për rikonstruksionin e spitalit psikiatrik Vlorë sipas masterplanit”, prokuruar, me fond limit 3 083 333 lekë (pa TVSH).